

Nazmi Troka




GJYQATAR PRANË GJYKATËS SË
APELIT VLORË

Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




↗ Pasuria bruto është rritur 5.6 herë.

+ 847,893 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete
në Bankë




Likuiditete
në Cash




Pasuritë e
Luajtshme



Pasuritë e
Paluajtshme



Huadhënie



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	15,546,778	52.2%
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	6,551,698	22.0%
Të ardhura nga toka bujqësore dhe pentaria	7,190,000	24.1%
Të ardhura të tjera	513,030	1.7%
Total	29,801,506	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

Pa Probleme

Subjekti Nazmi Troka deklaron në vitin 2003 pasuri të paluajtshme familjare në Kuçovë një shtëpi banimi në vlerë 1,200,000 lekë dhe tokë arë me sipërfaqe totale 8,000m², të përfituar nga ligji 7501. Gjatë viteve të deklarimit, nga kjo tokë bujqësore sigurohen të ardhura me vlerë 7,190,000 lekë.

Në vitin 2012, subjekti deklaron t'i ketë dhënë hua në vlerën 200,000 lekë vëllait. Në vitin 2014 deklarohet shtesë apartamenti banimi në vlerë 67,000 euro, me burim financimi një kredi bankare prej 25,000 eurosh dhe kursimet e akumuluar ndër vite [depozita bankare në vlerë 5,113,590 lekë dhe cash në vlerë 1,787,017 lekë]. Nga gjendja totale e kursimeve cash në fund të vitit 2017, 1,300,000 lekë i përkasin deklaruesit dhe 500,000 lekë babait të deklaruesit.